

NJOFTIM NR. 1, DATË 02.04.2020

“Për vijimin e procedurave të prokurimit për tenderit me objekt: “Shërbim i pastrimit të ambjenteve të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave”, Kërkesë për Propozim, Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat të marrëveshjes kuadër 36(tridhjetë e gjashtë) muaj, me fond të marrëveshjes kuadër 7,082,299 (shtatë milion e tetëdhjetë e dy mijë e dyqind e nëntëdhjetë e nëntë) Lekë pa TVSH dhe REF-54703-03-19-2020

Bazuar në VKM Nr.243, datë 24.3.2020 “PËR SHPALLJEN E GJENDJES SË FATKEQËSISË NATYRORE” (publikuar në FZ nr.48 datë 24.03.2020), dhe në Njoftimin e datës 31.03.2020 të Agjencisë së Prokurimit Publik, ku theksohet se: *“Autoritetet kontraktore duhet të vijojnë procesin e prokurimit vetëm për ato procedura prokurimi që lidhen ngushtësisht me mbulimin e nevojave të dala në kuadër të situatës së shkaktuar nga pandemia Covid 19 dhe që konsiderohen të domosdoshme”*, duke qënë se, pastrimi, higjena dhe dezinfektimi i ambienteve është i lidhur drejtpërdrejt me masat për parandalimin e COVID- 19, organi qendror blerës ABP vendosi të vijojë me zhvillimin e procedurave për tenderin me objekt: **“Shërbim i pastrimit të ambjenteve të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave”**, Kërkesë për Propozim, Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat të marrëveshjes kuadër 36(tridhjetë e gjashtë) muaj, me fond të marrëveshjes kuadër 7,082,299 (shtatë milion e tetëdhjetë e dy mijë e dyqind e nëntëdhjetë e nëntë) Lekë pa TVSH dhe REF-54703-03-19-2020.

Nisur nga fakti se, afati kohor për dorëzimin dhe hapjen e ofertave ishte përcaktuar: Data: 30/03/2020 Ora: 12:00; Vendi: eëë.app.gov.al, organi qendror blerës ABP ka vendosur të shtyjë afatin e fundit për dorëzimin dhe hapjen e ofertave për këtë procedurë prokurimi **për në datën 08.04.2020 ora 11:00.**

Hapja e ofertave do të bëhet në faqen zyrtare të internetit www.app.gov.al, si dhe pranë Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara, në Ministrinë e Brendshme, Sheshi Skënderbej, nr. 3, Tiranë.